

URDHËR
Nr. 493, datë 27.9.2024

PËR NJË SHITESË NË URDHRIN NR. 113, DATË 26.3.2024, “PËR DELEGIMIN E KOMPETENCAVE DHE CAKTIMIN E DETYRAVE TË ZËVENDËSMINISTRIT TË ARSIMIT DHE SPORTIT, ZNJ. ANA KAPAJ”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; të neneve 22 dhe 29, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”; të pikës 2, të nenit 6, të ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave” dhe të pikës 2, të nenit 11, të ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”,

URDHËROJ:

1. Në urdhrin nr. 113, datë 26.3.2024, të ministrit të Arsimit dhe Sportit, të ndryshuar, pas shkronjës “t”, të pikës 2, shtohet shkronja “th” me përmbajtje si më poshtë:
“th) ndjek dhe nënshkruan udhëzimet në fushën e arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor”.
2. Ngarkohet zëvendësministri, znj. Ana Kapaj, dhe Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Arsimit dhe Sportit për zbatimin e këtij urdhri.
Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTËR I ARSIMIT DHE SPORTIT
Ogerta Manastirliu